

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË
Dt.30.06.2025

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim palestër+Rikonstruksion i shkollës së bashkuar
Dervician,Bashkia Dropull”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 121.362.952 (Njëqind e njëzetë e një milion e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëndëqind e pesëdhjetë e dy)lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Dropull** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c ”c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2024** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për proceduratatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishit** të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- Kontrate
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtme:

- Kontrate
- Situacionin përfundimtar
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- Aktin e kolaudimit
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore **dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.**

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*” të ndryshuar, e cila përfshin kategorite e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- NP-1 A “Punime gërmimi në tokë”;
- NP-2 B “Ndërtime civile dhe industrial”;
- NP-3 D” Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industrial, veshje fasada”;
- NP-12 A “Punime të inxhinjerisë së mjedisit”;

Për punimet speciale të ndërtimit:

- NS-1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”;
- NS-2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”;
- NS-4 C “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”;
- NS-8 A “Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri”;
- NS-12 A “Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit”;
- NS-14 A “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV”;
- NS-18 A “Punime topogjeodezike”;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategorite dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 2,3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

KAT.	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Nr. An	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli I klasifikimit I kërkuar per kategorine respektive
NP-1	Punime gërmimi në tokë	2.25a	Gërmim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me goma 0.25m ³ , shkarkimi në tokë	Niveli A
		2.25	Gërmim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma, kova 0.25m ³ shkarkim tokë	
		3.89/a	F.V Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m ³ në kanale me gjerësi deri 2 m ,prani uji kat III me shkarkim në tokë	
		2.1	Gërmim dheu me krah e transport me k dore 10 m,kategoria III	

		2.5	Germim e mbushje dheu me krah kategoria III per themele, h = 1.5m	
		2.25	Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma, kova 0.25m3, shkarkim toke	
		2.48/an	Germim shkemb i forte me çekiç me ekskavator me zinxhir	
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	Perfshihet ndertimi i palestres se re		Niveli B
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Rikonstruksioni i plote i godines ekzistuese ku perfshihet shtrimi me pllaka dhe parket, suvatim i brendshem dhe i jashtem, termoizolimi i godines, veshje fasade, dyert dhe dritaret e reja, catia e re, sistemi elektrik nga e para, sistemi ngrohjes nga e para etj.		Niveli D
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	3.643	Mbjellje bari	Niveli A
		3.643/a	F.V. Dhe vegjetal per mbushje (brezat e gjelber)	
		3.96	F.V. Fidane Lule dekorative	
		3.961	F.V. Fidane Peme dekorative	
		3.962	F.V Fidane shkurre dekorative “Oleander”	
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	2.426/9	Prishje suvatim I jashtem	Niveli A
		2.430/2	Prishje çatie ekzistuese me tjegulla	
		2.426/11	Prishje suva e brendshme	
		2.426/12	Prishje suva e brendshme tavane	
		2.430/1	Prishje mur guri	
		2.426/9	Prishje suvatim I jashtem	
		2.430/2	Prishje çatie ekzistuese me tjegulla	
		2.426/11	Prishje suva e brendshme	
		2.426/12	Prishje suva e brendshme tavane	

		2.281	Prishje shtresa pllakash	
		An-2	Heqje dyer dritare+parmak ekzistues	
		An-3	Prishje instalime elektrike	
		An-4	Prishje instalime hidrosanitare	
		An-5	Prishje tavan	
		An-6	Heqje kangjella metalike	
		An-7	Çmontim instalimesh dhe paisjesh elektrike + transport 5 km	
		An-8	Çmontim instalimesh dhe paisjesh hidrosanitare + transport 5 km	
NS-2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel 2 1/2" x 3.25 mm	Niveli A
		2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 2" x 3.25 mm	
		2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø1 1/2" x 2.90 mm	
		2.494/5	F.V Saracineska me trup bronzi Ø 2 "	
		2.494/4	F.V Saracineska me trup bronzi Ø 1 1/2 "	
		2.494/3	F.V Saracineska me trup bronzi Ø 1 1/4"	
		2.491/e	F.V Tubo PE - HD Ø 50x4.6 mm, PN16	
		2.495	F.V Lavaman tualeti + mishelator	
		2.504	F.V WC-alla turke	
		2.501	F.V. WC allafrenga	
		2.515	F.V Pilete dysHEMEJE Ø 50 mm	
		2.215	F.V Bolier elektrik 80 litra	
		2.228	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR Pn 16-20 d = 63 x 6.4 mm	
		2.23	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR Pn 16 d = 50 mm	
		2.491/d	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16	
		2.491/c	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16	
		2.491/b	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16	
		2.535/g	Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9)	
		2.535/f	Termoizolim tubi Ø 1 1/2" me armofleks (d54x9)	
		2.535/d	Termoizolim tubi Ø 1 1/4" me armofleks (d42x9)	
		2.535/c	Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9)	
		2.535/b	Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9)	

		An.	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d125	
		An	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d110	
		An	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d75	
		An.	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d50	
		An.	F.V Rakorderi (bryla, braga, tee, reduksion, etj.) si dhe te gjithë aksesoret e nevojshem per montimin e tubove te shkarkimit	
		An.	F.V Aksesori per montimin e tubacioneve te RAU -PP: fasheta, vida, dado, tapa, paste lubrifikuese etc.	
		An.	F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 160 mm	
		An.	F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 200 mm	
		An.	F.V Element ndihmes dhe rakorderi per tuba PEHD	
		pj	F.V Rezervuar Vertikal zingato per furnizimin me uje, kapaciteti 2000 lit, De=1600 mm, H=2660 mm, lidhjet 1/2"	
		pj.	"F.V. Grup pompimi me shpejtesi variabel (inverter), per furnizimin me uje sanitar, me dy pompa Prurja: 10 m ³ /h, Prevalenca: 50 mKH ₂ O, Fuqia elektrike: 2.2 kW, Ushqimi: 3~380V / 50Hz, Lidhjet: 21/2", PN16 Shkalla mbrojtëse: IP54 E kompletuar me te gjithë aksesoret e nevojshem."	
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	2.84	Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15	Niveli C
		2.324b	Plintuse grez importi, h = 10 cm	
		2.324/2	Plintuse mermeri h= 10cm	
		2.297/b	Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm	
		2.297/a	Tavan me kartonxhes	
		2.330/1	Patinim tavani me stuko	
		2.326	Veshje me pllake majolike (tualetet)	
		2.200	Shtrese Iluster cemento 1:2, I = 20 mm	
		2.196/c	Hidroizolim me nje shtres llaci me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B per dyshemete	
		2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	

	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	
	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	
	An	Mur me tulle me vrima, h-3m, llaç perzier M 25 T=20-25cm	
	An	Vendosje shirit MDF ne mur ne lartesine e bankave dhe karrigeve	
	2.375/1	F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	
	2.383/1	F V dyer te brendeshme druri cilesi e I-re	
	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	
	2.84	Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15	
	2.71/1	Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 8m me llaç perzier M15 (t=25cm) (muri perimetral)	
	2.86	Mur me tulle me 6 vrima, h-3m, llaç perzier M15 (t=12 cm)	
	2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	
	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm	
	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33 cm	
	2.256/b	Mbulim çatie me panele sandwich	
	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	
	2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cimento. Pergatitur nga dy komponente A+B	
	2.326	Veshje me pllaka majolike	
	2.3	Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah	
	2.31	Suva brenda mur tulle h-4m me krah, llaç perzier M 25	
	2.358/b	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.	
	2.35	Suva xokoli me granil e çimento te zakonshme me spruco	
	2.31	Suva mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	
	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e I-re	
	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e I-re(brenda)	
	2.375/1	FV dritare d/alumini plastike me dopio xham	
	2.395/a	Dere d/alumini me mbushje element d/a.	

		2.386/2	Dyer Metalike te blinduara me kase metalike ne mur dhe mentesha kushinete sipas projektit	
NS-8	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	An	Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 30/37	Niveli A
		An	Kolona b/a monolite dhe mure C 30/37 h - 4m	
		An	Beton C 30/37 shkallë + pandus	
		2.109	Themel betoni C12/15 (per murin e gurit)	
		2.182	F V konstruksione metalike te thjeshta (rrethimin e fushes)	
		2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	
		2.181	F.V. Konstruksione metalike te perbera	
		2.166	F V hekur betoni periodik	
		2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	
NS-12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit	2.491/a	F.V Tubo PPR me rakorderi Ø 20 .mm	Niveli A
		2.491/c	F.V Tubo PPR me rakorderi Ø 25 mm	
		2.491/d	F. V Tubo PPR me rakorderi Ø40 mm	
		2.512/2	F.V. Kolektor shpendares 3/4" (4+4)	
		2.512/3	F.V. Kolektor shpendares 3/4" (5+5)	
		2.535/a	F.V Termoizolim armoflex me spesor 9 mm per tubo PPR 20 mm	
		2.535/b	F.V Termoizolim armoflex me spesor 9 mm per tubo PPR 25 mm	
		2.535/d	F.V Termoizolim armoflex me spesor 9 mm per tubo PPR 40 mm	
		An.	Skambiator siguriet x kaldaje	
		An.	Unaz e rreduk feme.feme.bronzit 02 x 1.1/2	
		An	Valvel sfer e drejt me boketon 1-1/2 m-f itap	
		An	Nipel bronzit e shkurte 1.1/2 x 1.1/2	
		An.	Ti bronzit femer 1 1/2"	
		An	Nipel e rreduk bronzit 1.1/2 x 3/4	
		An	Rrak.kryq bronzit 3/4	
		An	Rreduk.mash.feme bronzit 3/4 x 1/2	
		An	Termo manometer me filet mrapa d.63 ½ itap 4 bar x 120°C	
		An	Termostat zhytes 220v	
		An	Valvel Sigurie ff 3/4" t. 3.0 itap	

An	Nipel bronzit e shkurte 3/4 x 3/4
An	Valvel termostatike devijuese antikondense 3 rrugeshe d.1 1/2
An	Hollandez i drejt me oring bronzit 1.1/2 m-f
An	Nipel e rreduk bronzit 02 x 1.1/2
An	Nipel e rreduk bronzit 1.1/2 x 01
An	Valvel sfer e drejt farfal ideal m-f 1" itap
An.	Tub inox estensibel mash.-fem. 1 " 500-1000 ujit
An.	Brryl fem.mash.bronzit 01 x 01
An	Brryl fem.mash.bronzit 1 1/2" x 1 1/2"
An.	Prolung bronzit m-m 2" x 200
An.	Valvel ideal me leve alumini m/f 1.1/2" itap
An	Prolung bronzit m-m 1/2 x 150
An	Ti bronzit femer 1/2 - mashkull 1/2 – femer 1/2
An	Valvel sfer e drejt me boketon e farfal 1/2 m-f itap
An	Karikues automatik per kaldaj me manometer
An	Valvel sfere e drejt me boketon x mult. D. 16 x 1/2 f.
An	Rrubinet e thjesht portogoma me leve 1/2 itap
An.	Brryl inox 90° diam.160 ma
An.	Tub inoxi m-f gjatesi 1000 x 160 ma
An	Ti inox 90° diam.160 ma
An.	Kapele tub inox x kana fumarie d.160
An.	Tap inoxi kondense d.160
An	Unaz e rreduk feme.feme.bronzit 02 x 1.1/2
An	Guarnicion per tuba d.160 ma
An	Fashet murit inox x kane fumarie d.160
An	Fashet inox x lidhjen e tubave d.160
An	F. Tubo PEX/al,DN 12 (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar δ= 6mm
An	Rakorderi mberthimi (Ti, bryla..etj)
An.	Kapse tubosh ne dysheme dhe ne murre
An.	F. Valvol nderprerese radiator me sfer 1/2"
An.	F. Valvola ajernxjerrese 1/2"
An	F. Elemente fiksues ne mur
An	F.V Kolektor shpendares 1" (4+4)
An	F.V Kolektor shpendares 1" (5+5)
An	F.V Kasete kolektori
An	M. Element radiator alumini per klasat, interaksi 500 mm, Fuqia Termike > 110 W.

		An	M.Kaldaje me dru per ngrohje , kapaciteti 67kw	
		An	M.Autoklave 100lt e kuqe vetem per sisteme ngrohje	
		An	M.Pompe qarkulluese 32/12 12mt	
		An	M.Pompe qarkulluese 32/8 - 180 8mt	
		Pj	F.Rekuperator ajri me kapacitet 4000m3/h	
		Pj	F.Kaldaje me dru per ngrohje , kapaciteti 67kw	
		Pj	F.Autoklave 100lt e kuqe vetem per sisteme ngrohje	
		Pj	F.Pompe qarkulluese 32/12 12mt	
		Pj	F.Pompe qarkulluese 32/8 - 180 8mt	
		Pj	Testim, konfigurim dhe kolaudim (certifikim) I sistemit te ngrohjes	
	Impiante të brëndëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	2.485/d	F.V Prize "Shuko" 16A, 230V, dy module, ngjyre e bardhe	Niveli A
		2.485/d	Prize " Shuko" 16A, 230V, dy module, ngjyre e kuqe	
		2.487/b	F.V Kuti, suporte, kapak, 4 module	
		2.480/5	F.V Tub plastmasi Ø 31 - 36 mm	
		2.480/3	F.V Tub plastmasi Ø22 - 26 mm	
		2.480/2	F.V Tub plastmasi Ø 18 - 21 mm	
		2.483	F.V Celes i thjeshte nje polar 16A, 230V	
		2.481/5	Fv.percjelles PV-500 Ø 10 mm2	
		2.481/4	Fv.percjelles PV-500 Ø 6 mm2	
		2.481/3	Fv.percjelles PV-500 Ø 4 mm2	
		2.481/2	Fv.percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	
		2.481/1	Fv.percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	
		2.496	F.V Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar, L=1.5 m	
		An	F.V Kuader per cdo kat 54 modular (vende), komplet	
		An	F.V Kuader per dhomen teknike 36 modular (vende), komplet	
		An	F.V Kuti, suporte, kapak, 3 module	
		An	F.V Kuti plastike 4 module, jashte murit me kapak IP 55	
		An	F.V Kuti shperndares , montim brenda murit PT-6, IP40	
		An	F.V Kuti shperndares, montim brenda murit PT-7, IP 40	
		An	F.V Zile elektrikeD75, 230V, 75 dB	

An	F.V Celes buton pulsant
An	F.V Tub i drejte rigid Ø=25mm, se bashku me brryla, Ti, bashkuese, aksesore per fiksimin e tubit ne tavan etj
An	F.V Tub i drejte rigid Ø=20mm, se bashku me brryla, Ti, bashkuese, aksesore per fiksimin e tubit ne tavan etj
An	F.V Terminale fundore per kabllo TU Un=0.6/1 kV; S=(6- 10)mm2
An	F.V Terminale fundore per kabllo TU Un=0.6/1 kV; S=(1.5- 4)mm2
An	F.V Kuti, suporte, kapak, 3 module
An	F.V Celes Deviat 16A, 230V
An	F.V Çeles buton pulsant 16A, 230V
An	F.V Kuti shperndares 10x10x10cm, montim jashte tavanit IP55
An	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 1,5 mm2
An	F.V Kabllo multipolar bakri, Un=0,6/1 kV, tip FTG10OM1 type,S = 3 x 1,5 mm2, rezistent ndaj zjarrit perj 90min
An	Fv.Kabell antizjarr grade III 2x0.8 i kuq
An	F.V. Kabell elektrik bakri FROR 3x1.5
An	F.V Kuti shperndares 10x10x10cm, montim jashte tavanit IP55
An	F.V Priza interneti, tip RJ-45 FTP - Cat.6, metalike e skermuar
An	F.V Priza telefonie, tip RJ-45 F-TP - Cat.6, metalike e skermuar
An	F.V Konektore lidhes rrjeti me dy koka RJ-45 FTP-Cat.6, L=0.5m, metalike e skermuar
An	Fiber optike
An	F.V Kuti shperndares , montim brenda murit PT-6, IP40
An	F.V Kuti shperndares , montim brenda murit PT-7, IP40
An	F.V Kabllo rrejt kompjuterik , tip F/FTP - Cat.6, 350MHz deri ne 400 MHz, LSZH
An	F.V Koka per kabllo rrjeti, tip RJ-45 FTP-Cat.6, metalike e skermuar
An	F.V Konektore lidhes rrjeti me dy koka RJ-45 FTP-Cat.6,L=0.5m, metalike e skermuar
An	F.V Kabllo rrjeti kompjuterik, tip F/FTP-Cat.6, 350MHz deri ne 400 MHz, LSZH

An	F.V AKsesore montimi te pershtatshem per instalimin e karnerave te jashtme dhe te brendshme
An	F.V Shirit zingato Fe/Zn 30x5mm
An	F.V Shtize rrufeprite, tub zingato Ø=20mm, H=50cm, per mbrojtjen nga goditjet atmosferike
An	F.V Percjelles bakri I veshur me izolim PVC, ngjyre verdhe-jeshile CU, S=1x35 mm ²
An	F.V Shkeputes tokezimi, per matjen e rezistences
An	F.V Zbare tokëzimi bakri me 4 terminale, 230 x 50 x 5 mm
An	F.V Morseta bashkuese "T" & "X" universale tokezimi 30x5mm
An	F.V Aksesore fiksues per instalimin e shiritave zbrites ne mur me sistem kapote, I kompletuar me upa, prizhonier dhe distancator
An	F.V Aksesore montimi, kapse, vida, dado etj
An	F.V Puseta betoni per linjen kryesore te furnizimit te rrjetit te Internetit dhe telefonise, me kapak gize te rende me dim. 60x60x60cm
An	F.V Tubo korregato Ø=90mm, tip i rende me rezistence te larte mekanike
An	F.V Tubo korregato Ø=63mm, tip i rende me rezistence te larte mekanike
An	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 4 x 2.5 mm ²
An	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 1,5 mm ²
An	F.V Rele Muzgu modulare 16A, 250V
An	F.V Percjelles NO7V-K verdhe-jeshil S=1x16mm ²
An	F.V Ndriçues LED Panel inkaso, 60x60cm, 36W, 3600Im, 4000K
An	F.V Ndriçues LED Panel, i montuar jashte tavanit, 60x60cm, 36W, 3600Im, 4000K
An	F.V Ndriçues cilindrik LED, i montuar jashtë tavanit 25W, 2300Im, 4000K
An	F.V Ndriçues plafon rrethor LED jashte murit, 18W, IP44
An	F.V Ndriçues industrial LED L=1.2m, 43W, IP 65, 4000K, me difuzor opal hermetik

		An	F.V Ndriçues LED plafon, I montuar jashte murit 25W, 23001 4000K, IP65	
		An	F.V Ndriçues evakuimi me shenjë tregues dalje (EXIT), rezistent ndaj zjarrit IP-40, IK 07, LED 8W bat.NiCd me autonomi 3orë	
		An	F.V Ndriçues emergjence, rezistent ndaj zjarrit, LED 8W, IK 07, IP-6S,me bat.NiCd me autonomi 3orë	
		An	Shtylla dekorative ne oborrin e shkolles te pajisura me ndricues me energji diellore dhe te gjithë aksesoret perkates (h-4.5m)	
		An	F.V Ndriçues prozhektor LED. 150W. IP66 per ndricimin e fushes sportive	
		An	Panel kontrolli konvencional me 2 zona	
		An	Terminal per akses te kontrolluar me lexues karte dhe me PIN (nivel mbrojtje IP65)	
		An	F.V RACK kompjuetrik 19" 15U (Dimesionet 582x572x597 mm), me 2 module ushqimi me 8 priza " Shuko " 230V/16A + PE, kompletuar grupin e modulit te ventilimt	
		An	F.V Patch panel per rrjetin e Internetit + TF, me 24 porta RJ-45 tip FTP cat6	
		An	F.V Switch per rrjetin e IT-së, me 24 porta RJ-45 + 2 porte per fiber optike tip FT-cat 6	
		An	F.V Patch cord fiber optike me 2 koka konektoriale L=1m	
		An	F.V Kamera e brendshme, tip Dome POE IP, 5Mpx	
		An	F.V Kamera e jashtme, tip Bullet IP POE, 5Mpx, IP 66	
		An	(D) NVR deri ne 16ch IP hyrje kamerash	
		An	F.V Patch panel per rrjetin e CCTV, me 24 porta RJ-45, tip FTP- cat 6	
		An	F.V Switch i menaxhueshem Smart POE me 16 Porta RJ45 FTP Cat.6 + 2 porte per fiber optike, tip FT -Cat.6	
		An	F.V UPS, 3-tazor - I kompletuar me bateri - Fuqia: 10kVA - Tensioni ne hyrje: 400 V - Tensioni ne dalje: 400 V - Frekuenca: 50 Hz - Niveli i zhurmave: < 45 dBA - Temperatura e punës: 0 — 40 ° -Autonomia e UPS 10 min	
		An	F.V Monitor 17" LED, per monitorimin e kamerave	

NS-18	Punime topogjeodezike	2.258	Nenshtrese zhavorri	Niveli A
		2.261	F.V Shtrese rere	
		2.701	Shtresë çakëlli	
		3.183/c	Shtrese zhavor lumi t=20cm	
		3.21	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri	

Kategoria NP-1 A (Punime gjermimi në tokë)

Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise se punimeve të cilat përfshijnë gjermimet për themelet e godinës së re, gjermim për kanalizimet KUZ të shkollës, gjermime dhe sisteme të ndryshme të shesheve përpara shkollës për ndërtimin e terreneve sportive dhe shkallën e emergjencës, operatori ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NP-2 B (Ndërtime civile dhe Industriale)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise se punimeve të cilat përfshijnë ndërtimin nga e para të palestres, operatori ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin C nga 21 deri në 50 milion lekë për këto punime.

Kategoria NP-3 D (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash)

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise se punimeve të cilat përfshijnë rikonstruksionin total të objektit, operatori ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin D nga 101 deri në 200 milion lekë për këto punime.

Kategoria NP-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik.

Referuar zerave të preventivit kemi të bëjmë me punime si F.V. Dhe vegjetal për mbushje, Mbjellje bari natyral, F.V. Fidane peme, lule dhe shkurre dekorative. Përfshihen dhe punime gjermimi, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjate zbatimit të projektit në realizimin e plote të kontratës, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të këtyre mbeturinave të inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikëri dhe në kohë reale. Për këto arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NS-1 A (Punime për prishjen e ndertimeve)

Konsiderohet çmontimi i impianteve industrial dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe ciklin e materialeve.

Referuar zerave të preventivit kemi prishje të elementeve të godinës si: prishje e suvatimeve, prishje betony, prishja e dyshemeve, prishja e veshjeve me pllaka të mureve, heqja e dyerve dhe dritareve, çmontimi i rrjetit ekzistues elektrik dhe hidraulik. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NS-2 A (Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturimi i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundërzjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë punimet për nyjet sanitare, furnizimin e pajisjeve hidrosanitare, impiantet e mbrojtjes ndaj zjarrit, dhe sistemin e kanalizimeve dhe shkarkimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NS-4 C (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë të gjithë zërat e përmendur më sipër, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin B nga 21 deri në 50 milion lekë për këto punime.

Kategoria NS-9 A (Punime strukturore speciale)

Përfshin prodhimin në rrugë industrial dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të parandëruar të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdo lloji, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analizë laboratoriale nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizim dhe konsolidim të terreneve.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve kërkohet për të përfshirë ndërtimin e strukturave b/a dhe hekur me plinta e bazamente betoni+pllake themeli, kollona dhe trare betoni, prodhimi dhe montimi i shkallës së emergjencës me konstruksion metalik, prodhimi dhe montimi i konstruksionit metalik të palestres. Referuar punimeve të mesiperme operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë.

Kategoria NS-12 A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit)

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të kompletuara me punimet muratore,

plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë ku përfshihet komplet implementimi i sistemit të ngrohjes së bashku me kalldajën dhe aksesoret perkates, operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NS-14 A (Impiante të brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv etj)

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe rishtrukturuimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve, ku përfshihen punimet e pajisjet elektrike dhe elektronike, si dhe rrjeti i telekomunikacionit së bashku me linjat e internetit, sistemin e kamerave, sistemi i detektimit të zjarrit etj. operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NS-18 A (Punime Topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike special që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike.

Në këte objekt përfshihen edhe punime si piketimi, rievime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhurnime të ndryshme dhe lidhjet me sistemet koordinative relative dhe absolute. Për këte arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinjer Ndërtimi profili Strukturist
- Inxhinjer Gjeoteknik
- Inxhinjer Topograf/Gjeodet
- Arkitekt
- Inxhinjer Elektrik
- Inxhinjer Elektronik/Telekomunikacioni
- Inxhinjer Mekanik
- Inxhinjer Hidroteknik
- Inxhinjer Mjedisi
- Inxhinjer Gjeolog

Për drejtuesit teknik të paraqitet diploma, kontrata noteriale e punës, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

- Në lidhje me Inxhinjerin Elektronik/Telekomunikacioni, duhet të jetë i çertifikuar në nivel profesional për network nga organizma të mirënjohura ndërkombëtare.

- Inxhinjeri Mekanik ose Inxhinjeri Hidroteknik duhet të jenë të pasjitur me certifikate për Sisteme HVAC (Ngrohje-Ftohje-Kondicionim), e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për çertifikimin si më sipër kërkohej, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikates, si dhe institucionin/organizatën që ka lëshuar këtë dokument.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit

kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinjerët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinjerëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Inxhinjeri i Ndërtimit i Profilit Konstrktor/ Strukturist kerkohet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit që do të ndertohet nga e para, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv persa i perket trareve dhe kollonave b/arme dhe hekur, soletave, dhe struktures metalike te shkalles se emergjences.

Inxhinjeri i Ndërtimit i Profilit Gjeoteknik eshte i nevojshem pasi ai do te verifikojë ne terren kapacitetet mbajtese te tokes dhe lidhjen e saj me tipin e zgjedhur per implementimin e pllakes se themelit, persa i perket ndertimit te godines shtese. Inxhinjeri Gjeoteknik ka rëndësi të vecantë sidomos në rastin konkret me fushën e përcaktimit të karierave të materialeve që do të përdoren për nenshtrese zhavori, për shtresë stabilizuese si dhe për materialet që do të përdoren për pllaken e themelit dhe për materialet e betoneve te tjera.

Prania e inxhinjerit të ndërtimit me profil gjeoteknike nevojitet për të kryer provat e duhura gjeoteknike , për të verifikuar përputhshmërinë e përbërjes së tokës me parametrat e cilësuar në projekt si dhe për të përcaktuar kuotën e tabanit ku sforcimet e reja duhet të jenë brenda sforcimeve të lejuara.

Inxhinjeri Topograf/Gjeodet është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike duke perfshire punime si piketimi, rilevime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave te kërkuara nga projekti, azhornime të ndryshme, persa i perket sistemimit te terreneve te jashtme ku perfshihet sheshi perpara shkolles, fusha sportive dhe muri rrethues.

Arkitekti është kërkuar pasi kemi te bejme me punime ne fasaden e jashtme te objektit. Per zhvillimin sa me te mire te ketyre punimeve, asistenca nga arkitekti do te ishte e domosdoshme.

Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike, pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen instalime elektrike, do te kemi ndryshime linjash elektrike dhe ndryshim ndriçimi ne te gjithë ambientet e objektit te ri, te cilat kerkojne detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri elektrik gjate periudhes te zbatimit te punimeve.

Inxhinjeri Elektronik/Telekomunikacioni është i nevojshem për procesin e instalimit të sistemit të survejimit me kamera CCTV, sistemit të access control-s për kontrollin e hyrje-daljeve, rrjetin LAN, sistemin e detektimit të zjarrit, instalimin e pajisjeve si Rack, UPS, etj.

Lidhur me kërkesen për inxhinjerin elektronik/telekomunikacioni që të jetë i certifikuar në nivel profesional për networks mbahet në konsideratë se kjo certifikatë është shumë e nevojshme kur ka punime në rrjetin e internetit, rrjetin IT, punimet e telefonisë, sistemet e kamerave dhe të sigurisë etj. dhe kërkohej drejtimi, lidhja dhe konfigurimi i këtyre rrjeteve dhe pajisjeve. Gjithashtu parashikohet instalimi i sistemit komunikimi të të dhënave për të sinkronizuar edhe me sistemet e sinjalizimit kundër zjarrit. Me konkretisht nepermjet kësaj kualifikimi vërtetohet njohuritë dhe aftësitë që nevojiten për të instaluar, konfiguruar, operuar dhe zgjidhur një rrjet ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme, sic kërkohej dhe në preventivin e punimeve.

Inxhinieri Mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, ku përfshihet kompleti i ngrohjes dhe sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit MNZ sipas parashikimeve në projektin mekanik.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike duke përfshirë furnizimin dhe vendosjen e tubave dhe rakorderive, pajisjeve hidrosanitare (WC, lavaman, rubineteri etj), furnizimin e ujit sanitar, sistemin MNZ, dhe sistemin e kanalizimeve dhe shkarkimeve, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.

Lidhur me kërkesen ku Inxhinieri Mekanik ose Inxhinieri Hidroteknik duhet të jenë të pajisur me certifikatë për Sisteme HVAC (Ngrohje-Ftohje-Kondicionim), kërkohej pasi referuar preventivit përveç sistemit të ngrohjes kemi dhe sistemin e trajtimit të ajrit me rekuerator, dhe është e domosdoshme që Drejtuesi Teknik që do të ndjekë këto procese të jetë i specializuar dhe i profilizuar për të përket sistemeve të ngrohjes, ftohjes dhe kondicionimit.

Inxhinieri Mjedisit është i nevojshëm pasi kemi të bëjmë me punime germimi, ndërtimi, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjate zbatimit të projektit, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale, prandaj asistencë e një inxhinieri mjedisi do të jetë e domosdoshme.

Inxhinier Gjeolog është i domosdoshëm për të parë faktorët gjeologjikë të tokës në sheshin e ndërtimit, është përgjegjës për zbatimin e punimeve gjatë germimit të themeleve dhe plintave, dhe do të jetë i nevojshëm për hartimin e një relacioni dhe studimi gjeologjik përpara se të fillohet me punimet gjeoteknike dhe konstruktive të objektit.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin e kualifikuar** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinjer Ndërtimi
- Inxhinjer Perpunim Druri
- Agronom ose Inxhinier Pyjesh

Për stafin teknik të paraqitet diploma universitare, kontrata e punës, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Inxhinjer Ndërtimi është i nevojshëm në stafin mbështetës përveç stafit të drejtuesve teknike sepse punimet në aq kohë sa e përcakton grafiku i punimeve do të shtrihen në disa fronte njëkohësisht si ndërtimi i ri i palestres, rikonstruksioni i objektit, sistemimi i shesheve të shkollës dhe ndërtimi i terreneve sportive.

Inxhinjer Perpunim Druri është i nevojshëm pasi në preventiv janë parashikuar disa procese pune të fushës së punimit të drurit si shkallët e spektatoreve në palester me dru të perpunuar, veshja e mureve të shkollës me shirit MDF, binaret lidhur me catine dhe dyshemene të palestres etj.

Agronomi ose Inxhinieri Pyjeve është i nevojshëm për procesin e punimeve të gjelbërimit si mbjellje bari dhe pemesh. Me konkretisht nevoja për të patur një Agronom/Inxhinier Pyjesh në stafin e operatoreve ofertues lidhet me zërat si hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, humus, mbjellje bari në skarpat dhe vendosja fidanesh e bime kacavjerrese dekorative.

2.3.5. Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf të punonjësve të kualifikuar në përputhje me ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika të Shqipërisë.” si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)	Diplome shkollës mesme
- Teknik Mekanik	1 (nje)	Diplome shkollës mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkollës mesme
- Teknik Elektronik	1 (nje)	Diplome shkollës mesme
- Teknik Gjeometër/Topograf	1 (nje)	Diplome shkollës mesme
- Elektricitist	5 (pese)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Instalues panelesh diellore	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Hidraulik	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Hidroizolues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Specialist ngrohje-ftohje	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Karpertier	4 (kater)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Hekurkthyes	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Betonues	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Murator / Suvatues	7 (shtate)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Punëtor veshje fasade	4 (kater)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Pllakashtues	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome

- Montues parketi	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Bojaxhi	4 (kater)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Punetor duralumini	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Punonjes Gipsi	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Saldator	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Konstrukione metalike	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Marangoz/Mobilier	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Usta guri/Gurgdhendes	5 (pese)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Shofer	3 (tre)	Leje Drejtimi kategoria C minimalisht
- Manovrator	3 (tre)	Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale/ Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve për cdo kategori të mesiperme, Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Në rastin kur makineritë disponohen me qera për shoferët dhe manovratorët nuk kërkohet disponimi i tyre në listpagesat e shoqërisë, pasi këto punonjës mund të kontraktohen.

- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punës, numrin e amzës/regjistrimit dhe datën e lëshimit, dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistët e kualifikuar më sipër. (Në rast se institucioni lëshues i çertifikatës/dëshmisë/diplomës është privat, duhet të deklarohet dhe NIPT-i).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e gërmes c) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Tekniku Ndërtimi është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Tekniku Mekanik është i nevojshëm për ndjekjen e zbatimin e projektit mekanik, për realizimin e sistemit të ngrohjes, sistemin MNZ dhe furnizimin me ujë të ngrohtë.

Tekniku i Mesëm Elektrik është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve

elektrike, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses.

Tekniku Elektronik është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve si instalimi i rrjetit të telekomunikacionit së bashku me linjat e internetit dhe sistemin e survejimit me kamera, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses.

Tekniku Gjeometer/Topograf është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të ndërtimit nga e para si dhe punimet e sistemit të jashtëm. Të gjitha keto punime kërkojnë precizion në kuota dhe nivele të caktuara për piktimin dhe monitorimin e strukturave dhe elementeve të ndryshëm.

Elektricitet 5 (pese) janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet për sistemin elektrik do të fillojnë të kryhen në muajin e dytë (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish elektrik.

Konkretisht, vetëm për punime elektrike janë parashikuar 6,692.18 orë pune nga zërat e instalimeve për ndricim për të vazhduar me tej tek analizat jashtë liste të preventivi të punimeve.

Duke marrë në konsideratë dhe çmontim instalimesh dhe paisjesh elektrike që zgjasin rreth 37.9 orë pune, kemi në total janë 6,692.18 orë pune për punime elektrike.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se: $6,692.18 \text{ ore pune} / 8 \text{ ore} = 836.52 \text{ dite pune}$

në total për 6 muaj e 3 javë ose 27 javë ose 27 javë x 6 ditë/javë, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

$836.52 \text{ dite pune} / (27 \text{ javë} \times 6 \text{ ditë/javë}) = 5.16 \text{ punonjës elektrikist të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 6 muaj e 3 javë.}$

Duke qënë se punimet elektrike do të kryhen brenda muajit të 2-të deri në muajin e 8-të (sipas parashikimit të autoritetit kontraktor) njësia e prokurimit gjykon se këto punime mund të ecin paralelisht me punimet e tjera dhe mund të shtrihen në kohë, duke përgjysmuar numrin e nevojshëm të punonjësve elektrik si dhe duke iu ardhur në ndihmë operatorëve ekonomik ofertues në përmbushje të kriterit të mësipërm.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se pesë punonjës janë të mjaftueshëm për punime elektrike, duke përcaktuar 1 teknik të mesëm elektrik të pajisur me diplomë të shkolles së mesme si dhe 5 elektrikist të pajisur me dëshmi profesionale ose certifikat trajnimi.

Instalues panelesh diellore është i nevojshem për lidhjen e ndricuesave të jashtëm që marrin energjinë përmes paneleve diellore.

Hidraulike 3 (tre) janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet hidraulike do të fillojnë të kryhen në muajin e dytë (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish hidraulik. Konkretisht, për punime hidraulike nga zërat për punime hidro-sanitare dhe ngrohje të preventivi të punimeve për të kaluar me pas tek analizat janë parashikuar rreth 3937.19 orë pune.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se: $3937.19 \text{ ore pune} / 8 \text{ ore} = 492.14 \text{ dite pune}$

në total për 27 javë ose 27 javë x 6 ditë/javë, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

492.14 dite pune / (27 jave x 6 dite/jave) = 3.03 punonjës hidroizolues të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 27 javeve.

Hidroizolues 2 (dy) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të hidroizolimit në dysHEME dhe nyjet sanitare, me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve. Lidhur me kërkesën e mësipërme Në seksionin 2. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE janë parashikuar punime si:

2.196/c	Hidroizolim me nje shtres llaci me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B per dyshemete	452.60 ore pune
2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	455.70 ore pune
2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B	54.75 ore pune
An-14	FV membrane antiavulluese	870.00 ore pune

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet e hidroizolimit do të fillojnë të kryhen në javën e katërt (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish hidroizoluesish.

Konkretisht, për punime hidroizolimi janë parashikuar rreth 1,833.05 orë pune.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se: 1,833.05 ore pune / 8 ore = 229.13 dite pune

në total për 18 jave ose 18 jave x 6 dite/jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

229.13 dite pune / (18 jave x 6 dite/jave) = 2.12 punonjës hidroizolues të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 18 javeve.

Specialiste ngrohje-ftohje 2 (dy) janë të nevojshëm pasi punimet e sistemit të ngrohjes tek shkolla ekzistuese zënë një pjesë të konsiderueshme në zërat e preventivave të punimeve. Gjithashtu dhe tek palestra është parashikuar përveç sistemit të ngrohjes dhe sistemi i pastrimit dhe qarkullimit të ajrit me rekuperatore.

Duke marrë në konsideratë se punimet për sistemin e ngrohjes ë kryhen në 26 jave, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për punonjësish specialistë për sisteme ngrohje-ftohje.

Konkretisht, për punime ngrohje janë parashikuar **3,183.94** orë punë nga zërat e PUNIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE tek preventivi i punimeve, duke vazhduar me zërat nr 86-132 tek seksioni 21. ANALIZE JASHTË LISTE (shkolla) dhe zërat nr 30-41 tek seksioni 17. ANALIZE JASHTË LISTE (palestra).

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se: **3,183.94** ore pune / 8 ore = 397.99 dite pune

në total për 27 jave ose 27 jave x 6 dite/jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

397.99 dite pune / (27 jave x 6 dite/jave) = 2.45 punonjës hidroizolues të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 27 javeve.

Nga përlogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësit me dëshmi kualifikimi për specialist për sisteme ngrohje-ftohje, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Karpentier 4 (katër) janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen punime betoni, armaturat/betonformat) për kollonat, traret etj., duke qenë se në ambientin i ri që do të ndërtohet palestra e shkollës), ka shume volume punimesh me beton.

Nga sa më sipër argumentuar, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e ofertuesve për 4 (katër) karpentierëve, është në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë

Hekurkthyes 3 (tre), janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen përpunimi dhe lidhja e hekurit të ndërtimit duke përdorur mjetet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Duke analizuar preventivin e punimeve vërejmë se punonjësit e mësipërm garantojnë autoritetit kontraktor për zbatimin e punime të hekurit për ndërtimin e palestrës nga e para si dhe punime të ndryshme tek shkolla:

Tek seksioni 10. PUNIME HEKUR BETONI janë parashikuar punime si:

2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (godina ekzistuese)	54.57ore pune
2.166	F V hekur betoni periodik (palestra)	1,686.73 ore pune

Nga mbledhja e orëve të punës për punime hekuri, në total janë 1,741.30 orë pune për përfundimin e punimeve me sukses.

Nga një përlogaritje e thjeshtë vërehet se: **1,741.30** ore pune / 8 ore = 217.66 dite pune

në total për 12 jave ose 12 jave x 6 dite/jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

217.66 dite pune / (12 jave x 6 dite/jave) = 3.02 punonjës hidroizolues të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 12 javeve.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për **Hekurkthyes 3 (tre).**

Betonues 3 (tre) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të betonimit, me klasen e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve, duke marrë parasysh që kemi shtresa betoni nga e para, për palestren kemi pllake themeli, trare, bazamente e kollona, në volume të konsiderueshme.

Lidhur me këtë kërkesë, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, janë rreth 3,156.64 ore pune për tu realizuar në harkun kohor të 14 javeve.

Duke qenë se punimet e betonit janë në volume të mëdha si më sipër listuar, si dhe referuar orëve të punëve për këtë kategori punimesh ku është relativisht e madhe dhe konkretisht 3,156.64 orë pune, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Murator / Suvatues 7 (shtate) janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve suvase të brendshme, suvase të xokolit dhe suvatimeve në tavan sipas zërave të preventivave të punimeve.

Në seksionin Punime tavani dhe suvatimi ,te shkolles janë parashikuar punime si:

Suva solete h - 4 m me drejtues, me krah	1,951.90 ore pune
Suva brenda mur tulle h-4m me krah, llaç perzier M 25	4,283.40 ore pune
Suva xokoli me granil e çimento te zak, me spruco	176.40 ore pune
Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15	256.81 ore pune
Mur me tulle te lehtsuara dopio deri 8m me llaç perzier M15 (t=25cm) (muri perimetral)	2,523.30 ore pune
Mur me tulle me 6 vrima, h-3m, llaç perzier M15 (t=12 cm)	123.59 ore pune

Në total llogariten 9,315.44 orë pune gjithsej për punimet e muratures dhe suvatimeve që nevojitet domosdoshmërisht prania e muratorit dhe e suvatesit.

Duke qënë se punimet suvatimeve janë në volume të mëdha si më sipër listuar, duke u bazuar edhe se këto punime mund të realizohet për gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës si për rikonstruksionin e shkollës ashtu edhe për ndërtimin e palestrës, si dhe referuar orëve të punëve për këtë kategori punimesh ku është relativisht e madhe dhe konkretisht 9,315.44 orë pune, njësia e prokurimit gjykon se kë kërkuar një numër minimal punonjësish, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Punetor Veshje Fasade 4 (kater) janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve te fasades , veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.

Në seksionin 8. Punime tavani dhe suvatimi janë parashikuar punime si:

Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.	4,114.50 ore pune
--	-------------------

Në total 4,114.50 orë pune gjithsej për punimet lidhur me fasaden me polisterol te palestres. Nisur nga oret e punës të nevojshme për realizimin e këtyre punimeve si dhe periudhen kohore gjatë së cilës do të realizohen, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 4 (kater) Punonjes per veshje fasade duke garantuar për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Pllakashtrues 3 (tre) janë të nevojshëm për shtrimet e dyshemeve me pllaka porcelani, mermeri si dhe veshjen e tualeteve me pllaka gres etj.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, për rikonstruksionin e shkollës janë parashikuar punime të cilat kërkohet domosdoshmërisht prania e pllakashtruesve.

Shtrese me pllaka porcelanat	1,895.10 ore pune
Shtrese me pllaka mermeri t=2cm (davanciale mermeri)	172.70 ore pune

Shkalle montazhi mermeri	50.22 ore pune
Veshje me pllake majolike (tualetet)	614.08 ore pune

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se: **3,644.38** ore pune / 8 ore = 455.55 dite pune në total për 5 muaj e 3 jave ose 23 jave ose 23 jave x 6 dite/jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

455.55 dite pune / (23 jave x 6 dite/jave) = 3.3 punonjës pllakashtrues të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 5 muajve e 3 jave.

Montues Parketi 3 (tre) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të të shtrimit të dyshemesë me parket ne palestren e objektit dhe nje pjese tek shkolla ekzistuese.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, ne seksionin 4. PUNIME SHITESASH 2, te rikonstruksioni i objektit ekzistues është parashikuar zëri:

Shtrese parketi	104.60 ore pune
-----------------	-----------------

Gjithashtu dhe ne seksionin 4. PUNIME SHITESASH 2 dhe ne seksionin 17. ANALIZA JASHTË LISTE, tek ndertimi i palestres jane parashikuar zerat:

Shtrese parketi	2,269.82 ore pune
Plintues parketi h=10cm	28.80 ore pune

Në total 2,403.22 orë pune gjithsej. Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se;

2,403.22 ore pune / 8 ore = 300.40 dite pune në total për 3 muaj e 3 jave ose 15 jave ose 15 jave x 6 dite/jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

300.40 dite pune / (15 jave x 6 dite/jave) = 3.33 montues parketi të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 3 (tre) montues parketi duke caktuar një numër minimal për plotësimin e punëve

Bojaxhinj 4 (kater) janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të lysterjeve të brendshme dhe fasadës, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet e lysterjes së shkollës + palestrës nuk mund të kryhet gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës për shkak se është procesi i fundit që kryhet në përfundimin e një rikonstruksioni, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish bojaxhinj.

Në seksionin **11 PUNIME BOJATISJE** janë parashikuar punime lysterje si:

Shkolla ekzistuese

2.404/1 Boje hidroplastike cilesi e larte në sasinë 3,150 m2 rreth 1,134 orë pune

Palestra

2.404/1 Boje hidroplastike cilesi e larte në sasinë 650 m2 rreth 234 orë pune

2.404/1 Boje hidroplastike cilesi e larte (Brenda) në sasinë 640 m2 rreth 230.4 orë pune

Tek analizat:

Terreni sportiv

F.V Boje termoplastike (paste) per fushen e basketbollit ne sasine 640.00 m2 rreth 1,856 ore pune

Dyshemeja e palestres

Boje termoplastike (paste) per dyshemene perreth fushes dhe vijezeimin ne sasine 200m2, reth 520 ore pune.

Nga mbledhja e orëve të punës për lyerjen e shkollës, në total janë 3,974.4 orë pune për përfundimin e punimeve me sukses.

$3,974.4 \text{ ore pune} / 8 \text{ ore} = 496.8 \text{ dite pune}$ në total për 4 muaj e 3 jave ose 19 jave ose 19 jave x 6 dite/jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

$496.8 \text{ dite pune} / (19 \text{ jave} \times 6 \text{ dite/jave}) = 4.35$ punonjës bojaxhinj të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Punetor duralumini 2 (dy) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të dyer/dritare, me materialin e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, ne seksionin 12. PUNIME DYER DRITARE, jane parashikuar zërat:

Shkolla ekzistuese

FV dritare d/alumini plastike me dopio xham	234.95 ore pune
Dere d/alumini me mbushje element d/a.	31.68 ore pune

Ndersa tek palestra ne seksionin 11.Punime Dyer Dritare, jane parashikuar zerat:

Palestra

FV dritare d/alumini plastike me dopio xham	106.00 ore pune
Dere d/alumini me mbushje element d/a.	33.60 ore pune

Në total dalin 406.23 orë pune gjithsej.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se:

$406.23 \text{ ore pune} / 8 \text{ ore} = 50.77 \text{ dite pune}$ në total për 1 muaj ose 4 jave ose 4 jave x 6 dite/jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

$50.77 \text{ dite pune} / (4 \text{ jave} \times 6 \text{ dite/jave}) = 2.11$ punonjës duralumini të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 2 (dy) punetor duralumini për plotësimin e punëve të dyer dritare.

Punetor gipsi_2 (dy) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të shtresave, me materialin e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, ne seksionin 8 janë parashikuar zërat:

Tek seksioni 8. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI

2.297/b Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm - 54.50 ore pune

2.297/a Tavan me kartonxhes - 2,415 ore pune

Në total 2,469.5 orë pune gjithsej. Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se:

$2,469.5 \text{ ore pune} / 8 \text{ ore} = 308.68 \text{ dite pune}$ në total për 5 muaj e 3 jave ose 23 jave ose $23 \text{ jave} \times 6 \text{ dite/jave}$, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

$308.68 \text{ dite pune} / (23 \text{ jave} \times 6 \text{ dite/jave}) = 2.23$ puntor gipsi të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 2 (dy) puntor gipsi për plotësimin e punimeve te tavanit dhe suvatimit.

Saldator 2 (dy) dhe pergatites konstruksione metalike 3 (tre) janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Duke analizuar preventivin e punimeve vërejmë se punonjësit e mësipërm garantojnë autoritetit kontraktor për zbatimin e punime të hekurit për ndërtimin e palestrës nga e para si dhe procese të tjera pune si:

Per shkollen:

2.181 F.V. Konstruksione metalike te perbera - 228.76 ore pune

An- Kornizim i dritareve me celik COR-TEN – 75 ore pune

An- F.V. Kangjella dekorative te kompletuara dhe lyster me dy duar boje - 6 52.6 ore pune

Tek seksioni 5. Punime Hekur Betoni sa i perket ndërtimit të palestrës janë parashikuar punime si:

2.181 F.V. Konstruksione metalike te perbera - 1,300.32 ore pune

Nga mbledhja e orëve të punës për punime metalike, në total janë 2,236.64 orë pune përfundimin e punimeve me sukses.

Duke qënë se punimet e konstruksioneve metalike janë në volume të mëdha si më sipër listuar, duke u bazuar edhe se këto punime nuk mund të realizohet për gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës si për rikonstruksionin e shkollës ashtu edhe për ndërtimin e palestrës, si dhe referuar orëve të punëve për këtë kategori punimesh ku është relativisht e madhe dhe konkretisht 2,236.64 orë pune, njësia e prokurimit gjykon se kë kërkuar një numër minimal punonjësish, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për **saldator 2 (dy) dhe pergatites konstruksione metalike 3(tre)** te pajisur me certifikat trajnimi ose deshmi profesionale.

Marangoz / Mobilier 2 (dy) jane te nevojshëm për realizimin e vendosjes se dyerve te brendshme, shiritit MDF ne muret e klasave e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, jane parashikuar zërat:

Shtrese derrasa FM 2.5cm	1,392.00 ore pune
F V dyer te brendeshme druri cilesi e I-re	29.62 ore pune
Vendosje shirit MDF ne mur ne lartesine e bankave dhe karrigeve	275.00 ore pune
F V dere e jashtme druri me xham	14.17 ore pune
Dru i perpunuar (I kompletuar) per shkallet/uleset e spektatoreve	150.00 ore pune

Në total 1,710.79 orë pune gjithsej. Nga një përllogaritje e thjeshtë vërehet se:

$1,710.79 \text{ ore pune} / 8 \text{ ore} = 213.84 \text{ dite pune}$ në total për 4 muaj ose 16 jave ose 16 jave x 6 dite/jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

$213.84 \text{ dite pune} / (16 \text{ jave} \times 6 \text{ dite/jave}) = 2.23 \text{ marangoz të nevojshëm}$ për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për **2 (dy) marangoz/mobilier** për plotësimin e punëve të shtresave dhe punime dyer dritare.

Usta guri / Gurgdhendes 5 (pese) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të muratures se gurit, rinovimin e fasades se gurit dhe shtrimin me gure te sheshit me materialin e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, ne seksionin 8 jane parashikuar zërat:

Tek seksioni 14. PUNIME MURATURE GURI dhe zerar ne seksionin 21. ANALIZE JASHTE LISTE, kemi zerat si vijon:

Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç çimento M 25- 2,774.40 ore pune

Pastrim dhe larje guri ne fasade – 3,150 ore pune

Fugature llac cimento, M - 50, Mur guri – 1,040.88 ore pune

Veshje shkalle te jashtme me pllaka guri – 247 ore pune

Shtrese me pllaka guri natyror Rsh>80Mpa (Rezistenca ne shtypje) - 2,102.50 ore pune

Në total 9,314.78 orë pune gjithsej. Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se:

$9,314.78 \text{ ore pune} / 8 \text{ ore} = 1,164.34 \text{ dite pune}$ në total për 32 jave ose 32 jave x 6 dite/jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).
 $1,164.34 \text{ dite pune} / (32 \text{ jave} \times 6 \text{ dite/jave}) = 5.45$ ustallare guri të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për **5 (pese) ustallar guri/gurgdhendes** për plotësimin e punimeve të gurit.

Manovrator 3 (tre), Shofera 3 (tre)

Lidhur me kriterin e sipërcituar, njësia e prokurimit sqaron se punonjësit e mësipërm kërkohen në funksion të manovrimit të mjeteve të listuara si më poshtë;

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton (cope 2), Kamion me Vinc (cope 1), Kamionçina me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton (cope 2), Eskavator (cope 1), Minieskavator (cope 1), Minifadrome/Bobcat (cope 1)

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbi 20 ton 4 copë dhe kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton (3 copë); Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 deri në 5 ton 2 copë ; Autovinç me kosh 1 copë; Eskavator me zinxhir 2 copë, eskavator me goma 1 copë, fadromë me goma 2 copë, Minieskavator 2 copë Minifadromë 1 copë.

AK është në të drejtën e tij të parashikoj kritere minimale kualifikuese, duke gjykuar se këto punime mund të zgjaten edhe përtej një afati 1 muaj

2.3.6. Operatoret Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të pakten:

2.3.6/a – 1 (nje) punonjes të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë certifikatën perkatese e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe duhet të figurojë në listepagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

2.3.6/b – 1 (nje) Punonjes i pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq, shoqëri të licencuara/akredituara, ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë certifikatën perkatese si dhe duhet të figurojë në listepagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

2.3.6/c – 5 (pese) punonjes te trajnuar per punime ne lartesi te cilet te jene te pajisur me çertifikate “Per punime ne lartesi”. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” ku citohet..... “Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.

Specialisti per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune harton planin e sigurisë dhe të koordinimit ne kantier, parapërgatit një dosje, e cila përmban informacionet e nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar punëtorët, hartojnë planin operativ të sigurisë, kryejnë mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodic të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit te cilet janë te çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" dhe “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, jane te nevojshem per te menaxhuar emergjencat gjate punimeve dhe te sigurojne mbrojtjen e shendetit ne pune.

2.3.6/d – 1 (nje) Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese te leshuar nga Drejtoria e MZSH, si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentimi: Në Nenin 27 të ligjit Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri" (i ndryshuar), i ndryshuar, citohet: “Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj. bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta”

Referuar objektit të kësaj procedure prokurimi, si dhe bazuar mbi këtë legjislacion detyrues, në funksion të kontrollit të zbatimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në ndërtimet e reja, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë personel te trajnuar mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave pasi çdo vepër e përfunduar duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2.3.6/e – 1 (nje) punonjës të pajisur me “Çertifikatë e Audituesit Energjitik” në ndërtesa, e lëshuar nga Agjensia për Eficiensën e Energjisë në përputhje me VKM Nr.407, datë.19.06.2019. Per te permbushur kete

kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese te leshuar nga Agjensia për Efiçensën e Energjisë, si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentimi: Në Nenin 27 të ligjit Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri" (i ndryshuar), i ndryshuar, citohet: *“Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj. bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta”*

Referuar objektit të kësaj procedure prokurimi, si dhe bazuar mbi këtë legjislacion detyrues, në funksion të kontrollit të zbatimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në ndërtimet e reja, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese është e nevojshme që operatori ekonomik të disponoje personel te trajnuar mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave pasi çdo vepër e përfunduar duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2.3.6/f – 1 (një) Inxhinier, i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve te Ndërtimit nga Instituti i Ndertimit ose Inxhinier Materialesh. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese te leshuar nga Instituti i Ndertimit ose diplomën universitare lidhur me profilin Inxhinier Materialesh, si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise, ose te jete i kontraktuar me kontrate sherbimi/bashkepunimi me objekt proceduren e prokurimit ne fjale.

Argumentimi: Kërkesa është vlerësuar e nevojshme si kerkese teknike pasi objekti qe do rikonstruktohet dhe ai qe do te ndertohet nga e para jane godina publike ku ka levizje dhe prani te shumte te njerezve dhe per kete arsye materialet e perdorura duhet te jene te garantuara sipas cilesise dhe standarteve bashkekohore. Prandaj, testimi i besueshëm i materialit është metoda më e zellshme për të verifikuar se materialet e përdorura nga kompanitë në proceset e tyre të zbatimit do të përmbushin pritjet dhe do të përputhen me të gjitha rregulloret në fuqi.

2.3.6/g – 1 (një) Inxhinier, i certifikuar si Koordinator Saldimi sipas standartit SSH EN ISO 14731, lidhur me koordinimin dhe menaxhimin e saldimeve (Detyrat dhe Përgjegjesite). Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese te lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise, ose te jete i kontraktuar me kontrate sherbimi/bashkepunimi me objekt proceduren e prokurimit ne fjale.

Argumentimi: ISO 14731 është baza për përshkrimin dhe vlerësimin e detyrave dhe përgjegjësive për personelin e koordinimit të saldimit. Referuar preventivit kemi te bejme me nje volum relativisht te larte te punimeve te saldimit pasi do te ndertohet shkalla e emergjences, catia e palestres se re do te jete e gjitha me konstrukcion metalik, dhe rrethimi i oborrit do te behet me kangjella, ku kerkohet prerja dhe saldimi i tyre ne vend. Ky standard përcakton kërkesa specifike për kompetencën e personave me përgjegjësi saldimit dhe kjo përfshin: saldatorët, personelin NDT, inspektorët e saldimit dhe koordinatorët e saldimit. Ne menyre qe i gjithe procesi i saldimit te quhet i certifikuar dhe me siguri maksimale nevojitet prania e nje koordinatori saldimit.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për stafin teknik si me sipër, emer/mbiemer, profili i punes, numrin e amzës/regjistrir dhe datën e lëshimit, dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për stafin e kualifikuar më sipër. (Në rast se institucioni

lëshues i certifikatës/dëshmisë/diplomës është privat, duhet të deklarohet dhe NIPT-i).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **95** (nentedhjetë e pese) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për **3 muajt** e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.

Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në baze të volumeve dhe grafikut të punimeve.

2.3.8. Operatoret Ekonomike duhet të disponojë mjetet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	2
2	Kamion me Vinc	Ne pronesi ose qira	Cope	1
3	Kamionçina me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	2
4	Eskavator	Ne pronesi ose qira	Cope	2
5	Mineskavator	Ne pronesi ose qira	Cope	1
6	Autobetoniere	Ne pronesi ose qira	Cope	2
7	Autopompe betoni	Ne pronesi ose qira	Cope	1

8	Minifadrome/Bobcat	Ne pronesi ose qira	Cope	1
9	Ngjeshes	Ne pronesi ose qira	Cope	1
10	Depozite uji	Ne pronesi ose qira	Cope	1
11	Rul	Ne pronesi ose qira	Cope	1
12	Skeleri dhe rrjete rrethimi	Ne pronesi ose qira	m2	450
13	Armatura/lende druri per betonimet	Ne pronesi ose qira	m2	200
14	Meter lazer	Ne pronesi ose qira	Cope	3
15	Saldatriçe	Ne pronesi ose qira	Cope	2
16	Matrapik	Ne pronesi ose qira	Cope	4
17	Trapan	Ne pronesi ose qira	Cope	3
18	Perzieres kolle/llaci	Ne pronesi ose qira	Cope	2
19	Kompresor ajri	Ne pronesi ose qira	Cope	1
20	Vibrator	Ne pronesi ose qira	Cope	2
21	Betoniëre kantieri	Ne pronesi ose qira	Cope	2
22	Pompe Suvatimi	Ne pronesi ose qira	Cope	1
23	Kontenier/zyre kantieri	Ne pronesi ose qira	Cope	1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; për secilin mjet.
- Ndërsa për mjete të marra me qera/kontrata bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndërsa për mjete të marra me qera/ Kontrata bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ Kontrata Bashkëpunimi.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin

kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

- **Kamion veteshkarkues me kapacitet mbi 10 ton (2 cope);** Kerkohen kamionat pasi kemi transport te lendeve inerte, si dhe transporti i volumeve qe dalin nga punimet e germimit per prishje struktura betoni etj.

2.25a	Germim dheu themele e plinta me b=2m, ekskavator me goma 0.25m3,shkarkimi ne toke
2.5	Germim e mbushje dheu me krah kategoria III per themele, h = 1.5m
2.430/1	Prishje mur guri

- **Kamion me vinc;** prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceset si transportin dhe ngritjen me vinc te materialeve te imeta si hidraulike, elektrike etj.
- **Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton (2 cope);** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceset si Transport i mbeturinave, materiale hidraulike elektrike etj. Ky mjet është i favorshem pasi mund te qarkulloje ne cdo orar .

2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km
---------	---

- **Eskavator (2 cope);** Kerkohen per germime dhe mbushje te shtresave rrugore dhe mbeturinave.

3.89/a	F.V Germim dheu me eskavator me goma 0.25 m3 ne kanale me gjeresi deri 2 m ,prani uji kat III me shkarkim ne toke
2.25	Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma, kova 0.25m3 shkarkim toke
2.48/an	Germim shkemb i forte me çekiq me ekskavator me zinxhir

- **Minieskavator;** Kerkohet per germime te vogla te cilat do te behen ne shesh per kanalizimet dhe kullimet e ujrave.

An. F.V	Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave
---------	---

- **Ngjeshes;** eshte i nevojshem per ngjeshjen e dheut aty ku nuk mund te hyje rruli.
- **Autobetoniere (2 copë); Autopompe betoni 1 copë,** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojën për përgatitje llaçi për zerat si më poshtë :

An-	Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 30/37
An-	Kolona b/a monolite dhe mure C 30/37 h - 4m

- **Depozite uji (1 cope);** eshte e nevojshme ne rastin kur ka mungese te furnizimit me uje, kur duhet bere llaci per suvatimet, kolla per shtrimin e pllakave, ujitja e rruges dhe e bimeve e do te mbillen etj.
- **Rrul ;** Kerkohen per ngjeshjen e dheut ne oborrin e shkolles.
- **Skeleri dhe rrjete rrethimi:** Kerkohet skele metalike pasi kemi punime ne lartesi ne te gjithë siperfaqen fasades, per punimet e betonimit si dhe per muraturen.

An -	Pastrim dhe larje guri ne fasade
------	----------------------------------

2.84	Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15
2.71/1	Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 8m me llaç perzier M15 (t=25cm) (muri perimetral)
2.86	Mur me tulle me 6 vrima, h-3m, llaç perzier M15 (t=12 cm)
2.256/b	Mbulim çatie me panele sanduich
2.358/b	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.
2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e I-re
An -	Kolona b/a monolite dhe mure C 30/37 h - 4m

- **Armatura/lende druri per betonimet(200m2):** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht per betonim e pllakes se themelit,kollonave b/a monolite dhe mureve etj.

An-	Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 30/37
An-	Kolona b/a monolite dhe mure C 30/37 h - 4m
An-	Beton C 30/37 shkallë + pandus

- **Meter lazer-** eshte i nevojshem per matje te ndryshme dhe lehtesi pune sic mund te jene permasat e klasave,tualeteve,korridore,dyer,dritare etj.
- **Saldatriçe(2 cope):** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht per saldimin e tubove kangjellave, profileve metalike etj.

2.181	Konstruksione metalike te perbera
2.256/b	Mbulim çatie me panele sanduich
2.386/2	Dyer Metalike te blinduara me kase metalike ne mur dhe mentesha kushinete sipas projektit
An	F.V. Kangjella dekorative te kompletuara dhe lyer me dy duar boje

- **Matrapik (4 cope);** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, konkretisht për prishjen e ndertimeve, heqjen e shtresave te betonit etj.
- **Trapan-** eshte i nevojshem per te bere vrima ne materiale te ndryshme si dru,metal,plastike,mur si dhe per montimin e dyerve,instalimet elektrike etj.
- **Perzieres kolle/llaci (2 cope):**prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, konkretisht për shtrimin e pllakave,per shtrim shtreses lluster cemento etj.
- **Kompresor ajri** prezenca e tij eshte e nevojshme per per nguljen e gozhdeve per shtrimin e parketit.
- **Sharre per prerjen e gurit (1 cope);** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, konkretisht për shtrimin me pllaka grui natyror ne oborr.

An-Shtrese me pllaka guri natyror Rsh>80Mpa (Rezistenca ne shtypje)

- **Vibrator (2 cope);** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, konkretisht për kompaktimin e betonit.

An- Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 30/37

An- Kolona b/a monolite dhe mure C 30/37 h - 4m
An- Beton C 30/37 shkallë + pandus

- **Betoniëre kantieri (2 cope);** prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojën për gatitje të laci për shtresën e llustrës së cimentos, llac suvatimi etj.

An- Beton C 30/37 shkallë + pandus
2.262/4 Shtrese betoni C 16/20
2.200 Shtrese lluster cimento 1:2, I = 20 mm

- **Pompe Suvatimi:** prezenca e saj në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojën për aplikimin e suvase në mure etj

2.3	Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah
2.31	Suva brenda mur tulle h-4m me krah, llac perzier M 25
2.358/b	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.
2.35	Suva xokoli me granit e çimento të zakonshme me spruco
2.31	Suva mur tulle h~4m me krah, llac perzier M 25

Kontenier/zyre kantieri :prezenca e saj në kantieret e ndërtimit është e domosdoshme pasi shërben si strukture e perkohshme në vendin e ndërtimit për të ruajtur dokumente,projekte,kompjuter etj.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH **ISO 45001:2018** e përditësuar, ose (SSH EN **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH EN **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH EN **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.14 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018/45001:2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001:2018 është standart ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për

kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

ISO 3834-2:2021 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues që merr persiper punime saldimi, duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (strukturat metalike ku ka edhe saldime), me ritjen e cilesise se ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të cojnë në carje të nyjeve.

2.3.10. Operatori ekonomik për produktet/materialet/pajisjet si me poshte:

- Ngjites (koll) për pllaka
- Parket druri
- Tulla (t=25cm)
- Kartonxhes (pllake gipsi)
- Lesh guri mineral
- Hidroizolues 2-komponentesh
- Fino
- Hekur ndertimi
- Celik për konstruksione
- Boje hidroplastike
- Boje termoplastike (paste)
- Profile plastike për dritaret
- Pllaka guri natyror Rsh>80Mpa (Rezistenca në shtypje)
- Tubo HDPE të rrudhosur Ø110mm; Ø125mm; Ø160mm; Ø200mm; Ø250mm; Ø315mm
- Tubo PEX i termoizoluar
- Switch për rrjetin e IT-së
- Kamera e brendshme 5Mpx
- Kamera e jashtme 5Mpx, IP 66
- NVR deri në 16ch IP hyrje kamerash
- Element radiator alumini
- Kaldaje me dru për ngrohje, kapaciteti 67kw
- Panel kontrolli konvencional me 2 zona
- Detektor optik tymi konvencional
- Sistemi kapot (izolimi termik)
- Rekuperator ajri me kapacitet > 4000m³/h

për rastet që nuk është prodhues duhet të paraqesi autorizim prodhuesi, ose distributori të autorizuar. ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit **ose** midis **ofertuesit -distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.

Per produktet/materialet/pajisjet:

- Ngjites (koll) per pllaka

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 12004 ose ekuivalente (*përcaktimi i karakteristikave të ngjitësve të përdorur në instalimin e brendshëm dhe të jashtëm të pllakave*)

- Parket druri

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 14342 ose ekuivalente (*përcaktimi i karakteristikat dhe kërkesat përkatëse të produkteve të dysHEMEVE dhe parketeve prej druri*)

- Tulla (t=25cm)

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 1745 ose ekuivalente (*përcaktimin e vetive termike të muraturës dhe produkteve të muraturës së tullës*) dhe SSH EN 1996-1-2 ose ekuivalente (*përcaktimin e rezistences ndaj zjarrit*)

- Kartonxhes (pllake gipsi)

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 520 ose ekuivalente (*përcaktimin e karakteristikvet dhe performancs së pllakave të gipsit*)

- Lesh guri mineral

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 16516 ose ekuivalente (*përsa i përket vleresimit te emetimit te substancave te demshme*)

- Hidroizolues 2-komponentesh

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 7783 ose ekuivalente (*përsa i përket përcaktimit te vetive te transmetimit te avujve dhe ujit*)

- Fino

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 1015 ose ekuivalente (*ne perputhje me kërkesat për llaçet e muraturës të prodhuara në fabrikë*)

- Hekur ndertimi

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 10080 ose ekuivalente (*përsa i përket shufrave te hekurit te ndertimit*)

- Celik per konstruksione

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 10025-1 ose ekuivalente (*përsa i përket celikut te perdorur ne struktura metalike*)

- Boje hidroplastike

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 13300 ose ekuivalente (*referuar produkteve dhe sistemeve te bojrave per muret dhe tavanet*), dhe certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ku te vertetohet se produkti eshte ekologjik (EU ECO Label) ose ekuivalente

- Boje termoplastike (paste)

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 13036-4 ose ekuivalente (*per rezistencen ne rreshqitje ne terrenin sportiv*)

- Profile plastike per dritaret

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 479 ose ekuivalente *(per rezistencen e profileve ndaj te nxehtit)*

- Pllaka guri natyror Rsh>80Mpa (Rezistenca ne shtypje)

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 1926 ose ekuivalente *(persa i perket percaktimit te rezistences ne shtypje (Rsh) persa i perket pllakave te gurit), ku Rsh te jete mbi 80Mpa sipas preventivit*

- Tubo HDPE te rrudhosur Ø110mm; Ø125mm; Ø160mm; Ø200mm; Ø250mm; Ø315mm

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 13476-3 ose ekuivalente *(persa i perket sisitemeve te tubove plastike per kanalizime dhe kullime pa presion)*

- Switch per rrjetin e IT-së
- Kamera e brendshme 5Mpx
- Kamera e jashtme 5Mpx, IP 66
- NVR deri ne 16ch IP hyrje kamerash

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 50130-4 ose ekuivalente *(persa sistemeve te survejimit CCTV)*

- Element radiatorit alumini

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 442 ose ekuivalente *(persa i perket standartit europian per ngrohjen me radiatore)*

- Kaldaje druri

Duhet te paraqitet certifikate ne perputhje me Direktiven Europiane 2014/68/EU ose Ligjin Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, leshuar nga laboratorë të çertifikuar.

- Panel kontrolli konvencional me 2 zona
- Detektor optik tymi konvencional

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 54 ose ekuivalente *(persa i perket sistemeve të zbulimit dhe të alarmit të zjarrit)*

- Sistemi kapot (izolimi termik)

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN 13499 ose ekuivalente *(ne perputhje me kerkesat per për izolim termik për përdorim në ndërtesa)*

- Rekuperator ajri me kapacitet > 4000m3/h

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ne perputhje me SSH EN ISO 12100 ose ekuivalente *(persa i perket sigurise ne perdorimin e makinerive (rekuperatorit), SSH EN 6100 ose ekuivalente (persa standartit europian baze te testimit te pajisjeve/makinerive elektromagnetike), SSH EN 55011 ose ekuivalente (lidhur me minimizimin e zhurmave te krijuara nga pajisjet/makinerite industriale)*

Ne rast të disponimit të dokumentave te kerkuara në gjuhe të huaj, keto dokumente të paraqitente te përkthyer dhe noterizuar në gjuhen zyrtare shqipe.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë

09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe materialet e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojë qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj, pasi standartet e kërkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin Europian.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet dhe furnizimet që parashikohen të realizohen në preventiv, duhet të garantohet që mallrat dhe produktet qe do te perdoren të jenë sipas standarteve bashkekohore. Prandaj e gjejme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve europiane, ne menyre qe te provohet qe Operatori Ekonomik ka mundesi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit te dokumentave si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie, certifikata konformiteti dhe raporte testimi, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë ne perputhje sipas kerkesave te projektit.

2.3.11. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:

- Licence te leshuar nga QKL “Per grumbullim, ruajtje dhe transportim te mbetjeve inerte **Kodi III.2.B**, ku te paraqitet se bashku me aktin e miratimit.
- Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Liçencimit (QKL) **Kodi III.2.A** për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Argumentimi: Referuar preventivit të punimeve dhe natyrës së punimeve që do të kryhen, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të disponojnë dhe liçencat e nevojshme lëshuar nga Qendra Kombetare e Liçencimit (QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, si më poshtë, argumentojmë:

Duke qenë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (*dheu*), dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për

menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Po ashtu, referuar natyrës së punimeve që do të kryhen, në zbatim nenit 25 të ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar), nenit 6 pika 1 dhe nenit 20 pika 4 të ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis” (i ndryshuar), **duke qënë se Op. Ek. Pjesëmarrës, në cilësinë e zbatuesit të punimeve duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Kodi III.2.A)** në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”

2.3.12. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi i mirëfilltë.
- PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kërkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

Argumentimi: Keto kërkesa janë vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 është e lidhur me kërkesat teknike mbi menyren me grafikun e punimeve; fazat si dhe afatet e realizimit te punimeve.

2.3.13. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi financimi është parashikuar në buxhetin 2025-2027, por afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në

këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njesia e prokurimit thekson se financimi i këtij objekti është kryer në bashkepunim me Ministrinë e Arsimit dhe është i shtrire në vitet buxhtore 2025-2027.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit